



## Muhamedi dhe gënjeshtret rreth tij

### Description

#### Hyrje

Që kur Islami filloi të përhapë dritën e tij në lindjen e mesme, Afrikën veriore, Spanjë dhe në disa pjesë të Evropës, kisha e krishterë dhe udhëheqësit evropianë u ndjenë të kërcënuar fetarisht dhe politikisht. Misionarët e krishterë filluan të studiojnë Islamin që të përhapnin gënjeshttra dhe mashtrime rreth mësimëve të tij, dhe me qëllim që të nxisnin urrejtje dhe frikë në zemrat e njerëzve kundrejt Islamit. Me gjuhët e tyre kanë hedhur fjalë fyese dhe shfyturuese për profetin Muhamed (p.q.m.t.). Në këto pak faqe të këtij artikulli, në dashtë Allahu, do të mundohemi të pasqyrojmë polemikat therrëse të së shkuarës dhe të së tashmes, hedhur nga të krishterët kundrejt profetit Muhamed (p.q.m.t.).

#### Gjuha e misionarëve të krishterë

Kryebabai i polemikave anti-islame ishte Gjoni i Damaskut (675-749), dhe kur polemikat e krishtera filluan para pak shekujsh me periudhën e kryqëzatave, ai e bëri traditë talljen e Islamit dhe profetit (p.q.m.t.). Në librin e tij *De Haeresibus* pohoi se Kurani nuk u shpall por u krijua nga profeti Muhamed, i ndihmuar nga një murg i krishterë, Behira, për të përdorur Dhjatën e Vjetër dhe atë të riun që të nxirte një shkrim të ri të shenjtë. Ai gjithashtu pohoi se profeti (p.q.m.t.) krijoi versete kuranore për të përmbushur dëshirat e tij dhe këto përgjithësisht kishin të bënin me epshet dhe divijimet seksuale. Figura të tjera e pasuan Gjonin e Damaskut për të përhapur ide që e paraqisnin Islamin si një fe inferiore, priheshin nga Marakei, Hotinger, Nikola de Kus, Prideauks dhe të tjerë. Më vonë gjatë përpjekjeve evropiane për kolonizimin e Azisë dhe Afrikës veriore, të krishterët u ballafaquan dhe një herë me Islamin. Shumica e vendeve muslimane iu nënshtruan në mënyrë direkte e indirekte udhëheqjes evropiane. Më vonë qe politika e qeverive kolonizatore, e përkrahur pa dyshim nga kisha, për t'i paraqitur muslimanët si barbarë dhe për të shkatërruar institucionet islame, praktikat dhe ndikimet e tij.

Një pjesë e mirë nga ne mund të mos e kenë dëgjuar fjalën *Maometis* që rjedh nga fjala *Mahomet*, ku fjala *Maometis* nënkupton një numër kafshësh, d.m.th 666 copë në librin e shpalljeve. E gjithë kjo qe rezultat i të krishterëve të frymëzuar prej fantazmash të shenjtë. Ata thurën lloj-lloj historish për të njollosuar figurën e profetit (p.q.m.t.) me qëllimin për të shtrembëruar Islamin dhe për ta quajtur atë fe 'satanike'. Ashtu siç e ka thënë dhe Meulana Abdul Hasan Ali Nadui: “{Kleri, misionarët dhe studiuesit evropiane} e kanë paraqitur si profetin (p.q.m.t.) ashtu dhe mesazhin e tij, me ngjyrimet tmerrësisht tronditëse si pasoje e të cilave, kanë qarkulluar fjalë krejtësisht të rreme dhe të pabaza, nëpërmjet të

*cilave kanë fituar të holla të majme”.*

Na duhet këtu të pajtohemi unanimit me orientalistin W. Mongomeri Vat kur thotë : « *Nga gjithë burrat e mëdhenj që ka pasur kjo botë, asnjë nuk është njollosur aq shumë sa Muhamedi. ?shtë e lehtë për t’u kuptuar se si e nga erdhi e gjithë kjo. Për shekuj me radhë Islami ishte armiku madhor i Krishterimit sepse krishterimi nuk kishte kontakt të drejtpërdrejtë me asnjë shtet të organizuar që mund të krahasohej për nga fuqia me muslimanët. Perandoria bizantine, pasi humbi krahinat e saj në Siri dhe Egjipt, filloi të sulmojë Azinë e Vogël, ndërkohë që Evropa perëndimore kërcënohen me Spanjën dhe Siçilinë. Madje dhe para se kryqëzatat ta përqendronin vëmendjen në dëbimin e Sarcenëve nga toka e shenjtë, propaganda mesjetare për luftë, liruar nga çdo lloj kufizimi për bazime në fakte, po ndërtonte idenë e ‘armikut madhor’. Deri diku Muhamedi u shndërrua në Mahound, njeriu i errësirave. Me ardhjen e shekullit të XI-të idetë për Islamin dhe muslimanët që qarkullonin në ushtritë e kryqëzatave ishin aq të turpshme sa kishin ndikim negativ në moral. Kryqtarët ishin përgatitur të prisnin më të keqen e mundshme nga armiqtë e tyre, dhe kur panë shumë kalorës të moralshëm në atë mes, u mbushën me ndjenja mosbesimi për autoritetet e besimit të tyre.”*

Ishte pikërisht koha e kryqëzatave ku u hodhën akuzat më të liga për profetin (p.q.m.t.) dhe Islamin. Karen Armstron na tregon neve se gjatë kryqëzatave “...biografite për Muhamedin nga të krishterët e përshkruajnë jetën intime të profetit në atë lloj forme që shfaq shumë më tepër problemet e tyre seksuale, sesa për të vërtetat e jetës së profetit. Thuhej, krejtësisht në mënyrë të gabuar se Kurani e anashkalonte çështjen e homoseksualitetit dhe nxiste forma marëdhëniesh intime kundër natyrshmërisë njerëzore. Madje një studiues pohoi se ndotësia e epshit mes muslimanëve as që nuk mund të merrej me mend; ata ishin të zhytur në këtë përlyerje nga maja e gishtit gjer tek qimja e flokut. Së shpejti kisha do të fajësonte çdo grup që nuk i përkiste bashkësisë së krishterimit, për praktika seksuale jo të natyrshme dhe të tepruara dhe të krishterët e shekullit të XII stigmatizuan ‘herezinë’ e Islamit duke mallkuar atë çka ata e quanin shfrenim seksual.”

Ky stigmatizim i ‘shfrenimit seksual’ nga kryqtarët për ata ‘muslimanë të mallkuar’ mbështetet akoma më tej kur domenikani Friar Humbert i Lionit thotë se: “As që u mësoi Muhamedi atyre për thjeshtësinë...por përkundrazi u lejoj atyre shumë kënaqësira, të martoheshin me shumë gra, të abuzonin me to e të tjera të kësaj natyre... shumë të krishterë kalojnë dhe do të kalojnë në fenë e saracenëve.”

Në shekullin e XVI-të, nisi lëvizja protestante nën drejtimin e Luterit (1483-1546) dhe Kalvinit (1509-1564). Qëndrimi i tyre nuk qe i ndryshëm nga katolikët e krishterë prej të cilëve u larguan. Qëndrimi i Luterit ndaj Islamit shihet në fjalët e tij: “Ai që lufton kundër turqve (muslimanëve), duhet ta dijë se po lufton armikun e Zotit, blasfemues të krishtit, për më tepër, djallin vetë...”

As qëndrimi i Kalvinit kundrejt Islamit nuk ishte i ndryshëm. Tek protestantët e Gjermanisë fjalët Mahoun dhe Mahound përdoren për t’iu drejtuar profetit Muhamed, që në gjermanisht don të thotë **qen**, ndërsa në gjuhën e skocezëve **djall**, me të cilën frikësonin fëmijët.

Nga shembujt të shumtë pohimesh të pabazuara për profetin (p.q.m.t.) shkruar nga misionarët e krishterë dhe orientalistët, po përmendim të mëposhtmit:

**Dante Aligeri:** poet nga Firencia e Italisë, në poemën e tij epike Komedia Hyjnore, tha se një nga vizitat e tij ai pa profetin Muhamed në shkallën e katërt të zjarrit.

**Kenga e Rolandit** po ashtu përmban një sërë lirikash ku tregon në poezinë e tij për luftërat që Karli i madh kishte zhvilluar me muslimanët, dhe se si ai i shkatërroi idhujt që ata adhuronin. Më tej Roland tregon se muslimanët në Andaluzi (muslimanët e Spanjës) adhuronin një trini idhujsh me emrat përkatës Mahomed, Tarfagan dhe Abulun.

**D.S Margolith** shkroi në *Biografia e Muhamedit* se profeti ishte 'një person që përdorte magji. Ai kishte takime të fshehta në festivale masonike të ngjashme dhe shokët e tij kishin shenja për t'u dalluar, d.m.th hiqnin fundin e turbanëve të tyre.'

**H,A Lamens**, një prift dhe jezuit, shkruante se Muhamedi "hante shumë, u shkonte pas dëshirave seksuale dhe vdiq nga sëmundja e stomakut".

**Papa Bardo** shkroi se profeti ishte 'Një protagonist i shkretëtirës Sahara dhe vdiq si pasojë e një helmimi.'

**Pridok** mes të tjerash, shkroi dhe këto fjalë: "Islami është fe e pasuesve të djallit. Muslimanët janë një racë injorante dhe Kurani nga fillimi e gjer në fund është i mbushur me histori të pamundshme."

Duke lexuar të gjithë shembujt e mësipërm, lexuesi mund të mendojë nëse është Shpirti i Shenjtë i të krishterëve apo vetë Djalli që i frymëzoi në atë vepër të shëmtuar të tyre. Qoftë dhe ai më sipërfaqësori në diturinë Islame, mund ta dallojë fare lehtë se të gjitha këto thënie janë gënjeshtër dhe gënjeshtër të mallkuara bile. Nuk ka dyshim se kjo nuk mjafton për t'i ndaluar të krishterët së përsërituri herë pas here këto thënie të shpifura.

Megjithatë ka njerëz që e kanë studiuar jetën e profetit Muhamed (p.q.m.t.) si dhe Islamin. Dhe ata nuk zotërojnë ndonjë sopatë për të grirë ashtu si misionarët e sipërpërmendur. Montgomeri Vat që shqyrton akuzat e shumta nga pirgu i madh i akuzave që i janë ngjeshur profetit (p.q.m.t.), del në përfundimin: "Për brezin dhe kohën e tij Muhamedi ishte reformues, madje reformues dhe në fushën e moralit. Ai krijoi një system të ri sigurie shoqërore dhe një strukturë të re familjare, nga ku të dy ishin një përmirësim i ndjeshëm i atyre ekzistuese. Për këtë ai përshtati për komunitetet atë që ishte më e mira për moralin e nomadëve, dhe vuri një strukturë fetare dhe shoqërore të vlefshme dhe për racën njerëzore të ditëve tona."

Poashtu edhe Tomas Karlajl në lidhje me shpifjet perëndimore ndaj profetit Muhamed, u shpreh si vijon: "Hipotezat e kohëve të fundit për Muhamedin, se ai ishte një mashtrues, mishërim e gënjeshtërës, se feja e tij është thjeshtë një mashtrim dhe kotësi, këto kohët e fundit janë dobësuar sa nuk ka ku vete. Këto gënjeshtër të cilat zemrat e nxira ziliqare i kanë hedhur mbi figurën e këtij njeriu, janë fort të pahijshme të përdoren qoftë dhe për vet ne... Një shpirt i madh i qetë, një që nuk mund të jetë veçse i ndershëm. Për botën ai ishte zgjimi. Vetë Krijuesi i saj kishte urdhëruar kështu."

Në po të njëjtën linjë me Vatin, Rozher Dëpaskua shprehet si vijon: "Në përgjithësi ai që ka zemrën e çliruar nga paragjykimet, mund të pajtohet me një orientalist si Montgomeri, kur ai shkruan se 'nga të gjithë burrat e mëdhenj që ka mbajtur kjo tokë, askush nuk ka patur aq armiq sa Muhamedi'. Duke i kushtuar thuasje gjithë jetën studimit të jetës së profetit (p.q.m.t.), arabët britanikë shtojnë se 'vështirë të kuptohet se pse ky ka qenë rasti', për të gjetur qoftë dhe një sqarim të arsyeshëm se përse për shekuj me radhë krishterimi e trajtoi Islamin si armikun e tij të përbetuar. Dhe megjithëse evropianët e sotëm e shohin Islamin dhe themeluesin e tij nën një dritë disi më objektive, 'shumë nga paragjykimet e lashta ende kanë mbetur tek ta'.

## **Date Created**

16/10/2014

## **Author**

erasmusi